



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1334/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Ramush Bardiqi kryetar, Dren Rogova dhe Krenar Berisha, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Management & Development Associates” LLC, me seli në Prishtinë, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson V.H. avokat nga Prishtina kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson E.P., me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.372/22 të datës 06.03.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.02.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e paditësit “Management & Development Associates” LLC, me seli në Prishtinë.
- II. VËRTETOHET Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.372/22 i datës 06.03.2023.
- III. Mbetet e pashqyrtuar pika I (në) e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.372/22 i dt.06.03.2023.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.372/22 të datës 06.03.2023, në pikën I të dispozitivit është aprovuar pjesërisht si e bazuar kërkesëpadija e paditësit “Management & Development Associates” LLC., Anulohet pika II e Vendimit Psh.nr.327/17 e datës 27.09.2017, i nxjerr nga Paneli Shqyrtues i Prokurimit pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe çështja i kthehet të paditurit në rivendosje. Në pikën II të dispozitivit Refuzohet pjesërisht si e pabazuar kërkesëpadija e paditësit “Management & Development Associates” LLC., për pjesën me të cilën ka kërkuar që të obligohet i padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit t’i kompensoj dëmin në emër të fitimit të humbur në shumë prej 205,493.18€ me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar, për shkak të: shkëljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e paditësit Management & Development Associates” LLC, në tërësi si e bazuar dhe të detyrohet Organi Shqyrtues i Prokurimit që paditësit t’ia kompensoj dëmin financiar të

shkaktuar në lartësi prej 205,493.18€ sipas ekspertizës financiar të datës 26.02.2021, e të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë, pas kalimit të afatit prej 15 ditë nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të detyrueshëm.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se në procedurën administrative të ankesave, e paditura Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, me vendimin PSH. nr.327/17 i datës 29.09.2017, në pikën I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e operatorit ekonomik Management & Development Associates” LLC, - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Informimi publik për zgjedhjet Lokale 2017” Lot1, me nr.prok:”320/17/005/211”, iniciuar na Autoriteti Kontraktues Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në pikën II të dispozitivit vërtetohet njoftimi për dhënie të kontratës i AK-së / Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Informimi publik për zgjedhjet lokale 2017” Lot1, me nr.prok:”320/17/005/211”. Në pikën III Menaxhmentit të Prokurimit të AK-së i tërhiqet vërejtja e fundit, për shkak se nuk ka kërkuar me kohë vazhdimin e validitetit të ofertave, ndërsa nëse vazhdon në të ardhme në lëshime të tilla, OSHP do të veproj sipas nenit 23.9 të Ligjit për prokurim Publik të Kosovës nr.04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092. Në pikën IV Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Në pikën V mosrespektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr.04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues. Në pikën VI meqenëse ankesa e operatorit ekonomik ankues Management & Development Associates” LLC, - Prishtinë, aprovohet si pjesërisht e bazuar i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Në pikën VII Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Paneli Shqyrtues i Prokurimit Publik, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 27.10.2017, me pretendim se vendimi i të paditurës është i pa drejtë dhe i paligjshëm.

Dhomat e shkallës së parë pas shqyrtimit të padisë së paditësve paraqitur kundër vendimit të paditurës OSHP-së, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor datës 06.03.2023, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon pjesërisht si të bazuar, e anulon pikën II të vendimit kontestues dhe e refuzon pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësit në lidhje me kompensimin e dëmit në emër të fitimit të humbur, me arsyetimin se Lidhur me pikën II të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, gjykata vendosi duke u mbështetur në nenin 119 par.3 të LPP-së i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.05/L-068 i cili përcakton se: *“3.Nëse pas shqyrtimit të cekur më lartë, gjykata konstaton se një pretendim i bërë nga parashtruesi i ankesës në ankesën e tij të mëhershme që i është dorëzuar OSHP-së është bërë në mënyrë të vlefshme, gjykata lëshon një urdhër (i) duke e shfuqizuar ose ndryshuar çfarëdo urdhri ose vendimi të marr nga OSHP-*

ja, dhe/ose (ii) nëse parashtruesi i ankesës mund të demonstroj se ai është dëmtuar nga veprimi ose mos-veprimi i autoritetit kontraktues, atëherë gjithashtu gjykata mund të kërkoj nga autoriteti kontraktues që t'ia paguaj parashtruesit të ankesës kompensimin për dëmin e shkaktuar". Duke qenë se në këtë rast i paditur ka qenë vetëm Organi Shqyrtues i Prokurimit, gjykata ka vlerësuar se nuk ka mundur ta obligoj kompensimin e dëmit që ka pësuar paditësi, pas që dispozita e lartcekur përcakton në mënyrë të qartë që gjykata mund të kërkoj vetëm nga autoriteti kontraktues kompensimin e dëmit ndaj operatorit ekonomik. Andaj në bazë të kësaj, gjykata lidhur me çështje e kompensimit të dëmit, nuk ka bërë vlerësimin nëse ekziston baza ligjore për kompensimin e dëmit material- fitimit të humbur, pasi që ka konstatuar se të paditurit i mungon legjitimiteti pasiv për një kërkesë të tillë, andaj të njëjtën vendosi ta refuzoj në tërësi.

Qëndrimin juridik të Dhomës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, Dhoma e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë i'u ka referuar dispozitave ligjore të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik.

Sa i përket pretendimeve ankimore se Dhoma e shkallës së parë ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave nga neni 182.2 pika (n) të LPK-së, ngase ky aktgjykim ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos për faktin se pika II e dispozitivit të aktgjykimit është kontradiktore me arsyet e aktgjykimit, Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, nuk i aprovoi këto pretendime si të bazuara ndërsa aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij i janë dhënë arsyet të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Kolegji i kësaj gjykate e pranon si të bazuar arsyetimin e aktgjykimit të Dhomës së Shkallës së Parë, lidhur me pikën II të dispozitivit të Aktgjykimit, për faktin se bazuar në nenin 119 par.3 të LPP-së i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.05/L-068 është përcaktuar se *“Nëse pas shqyrtimit të cekur më lartë, gjykata konstaton se një pretendim i bërë nga parashtruesi i ankesës në ankesën e tij të mëhershme që i është dorëzuar OSHP-së është bërë në mënyrë të vlefshme, gjykata lëshon një urdhër (i) duke e shfuqizuar ose ndryshuar çfarëdo urdhri ose vendimi të marr nga OSHP-ja, dhe/ose (ii) nëse parashtruesi i ankesës mund të demonstroj se ai është dëmtuar nga veprimi ose mos-veprimi i autoritetit kontraktues, atëherë gjithashtu gjykata mund të kërkoj nga autoriteti kontraktues që t'ia paguaj parashtruesit të ankesës kompensimin për dëmin e shkaktuar”*. Në rastin konkret ashtu siç është sqaruar edhe në aktgjykimin e ankimuar, gjykatës i mungon legjitimiteti pasiv për një kërkesë të tillë, pasi që autoriteti kontraktues nuk është palë e paditur në procedurë, ndërsa gjykata nuk mund ta obligoj për kompensim të dëmit Organin Shqyrtues të Prokurimit.

Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se nuk kemi vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, apo aplikim të gabuar të drejtës materiale, dhe se arsyetimi i Dhomës së shkallës së parë është i drejt, i ligjshëm dhe i mbështetur në prova dhe fakte, pasi që Dhoma e shkallës së parë e ka arsyetuar vendimin e saj duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Dhomat e Shkallës së Dytë i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera të palës ankuese në ankesë mirëpo, të njëjtat ishin të pa bazuara dhe nuk kishin ndonjë ndikim në vendosje ndryshe, andaj edhe vendosi që aktgjykimin e shkallë së parë ta vërteton si të drejtë dhe të ligjshëm.

Gjykata ka vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, pasi që pika I (një) e aktgjykimit të ankimuar, nuk kanë qenë objekt ankimimit, pasi pala paditur nuk ka ushtruar ankesë, ndërsa paditësi nuk ka interes juridik që aktgjykimi të goditet në pjesën aprovuese, andaj në këtë pjesë ka mbetur i pa shqyrtuar.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, lidhur me nenin 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1334/23 datë 22.02.2024

Kryetar i kolegjit, gjyqtari

Ramush Bardiqi